REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br 39/17, 40/16, 41/17
Data/Datum 24.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: ***"Ministria e Punëve të Brenshme".***	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen e OE ***„Mercom Company"shpk*** - Prshtine nr. **39/17**, OE, ***"Europa Partners"shpk*** – Prishtinë, nr. **40/16**, dhe OE ***"Astraplan"shpk*** – Prishtinë, nr. **41/17**.		
Datë:	**24.02.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-068, dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik, ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesat e parashtruara me dt. **08.02.2017**, ***Mercom Company"shpk*** - Prshtine nr. **39/17**, me date. **09.02.2017**, nga OE, ***"Europa Partners"shpk*** – Prishtinë, nr. **40/16**, dhe me daten **09.02.2017**, nga OE ***"Astraplan"shpk*** – Prishtinë, nr. **41/17**, kundër AK – **Ministria e Punëve të Brendshme,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ***"Ndërtimi i aneks Objektit të Agjencisë për Forenzikë-Faza II", me nr të prokurimit: 214/16/052/521.***

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Korporata Energjetike e Kosoves".**
- Panelit Shqyrtues - "OSHP".
- OE - ankues - ***„Mercom Company"shpk*** - Prshtinë
  "Europa Partners"shpk – Prishtinë,
  "Astraplan"shpk – Prishtinë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		14.02.2017		**20.02.2017**		**24.02.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

OSHP, më datë, **08.02.2017,** ka pranuar ankesën me nr. **39/17,** nga OE "***Mercom Company***" **sh.p.k-**Prishtinë **,** poashtu me datën **09.02.2017**, ka pranuar ankes me nr. **40/17,** nga OE "***Europa Partners***", shpk – Prishtinë, si dhe më datën **09.02.2017**, ka pranuar ankesën me nr. **41/17,** nga OE "***Astraplan***",shpk – Prishtinë , kundër AK – **Ministria e Punëve të Brendshme,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ***"Ndërtimi i aneks Objektit të Agjencisë për Forenzikë-Faza II", me nr të prokurimit: 214/16/052/521***.

Konform nenit 113.1, të LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **"Ministria e Punëve të Brendshme".**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , "Mercom Company"- sh.p.k-Prishtinë

Pikat e Ankesës nga OE "**Mercom Company"- sh.p.k-Prishtinë** *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1 dhe 2

Neni 7. Barazia ne trajtim / jo diskriminim paragrafi 1 dhe 2

Neni 8. Planifikimi i Prokurimit paragrafi 1 dhe 1.3

Neni 10. Mjetet për promovimin e Transparencës paragrafi 2,3,4,5

Neni 54. Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, paragrafi 1,1.1

Neni 55. Mënyrat e Komunikimit,paragrafi 1.

Neni59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,paragrafi 2

Neni 62. Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit,paragrafi 1,1.2

Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 39. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publikë Neni 113 i Ligjit nr 02/L-28-Menyra e berjes se njoftimeve

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

AK - ja ka bere shkeljen e neneve te lartecekura:

Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi I dhe 2

Ak-ja ka shkelur kete nen duke na eliminuar nga gara si ofertuesi me i lire ne mesin e 5 ofertuesve dhe gjithashtu komisioni vlersues duke propozuar OE me te shtrenjte per dhenje te kontrates. Ak-ja ka shkelur edhe piken 2 te ketij neni duke anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit.Sqarojme se Buxheti ka qene i caktuar Ne FDT me vleren 399,587.83 e ndersa ofertuesi me i lire sipas Procesverbalit te hapjes kemi qene ne me vleren 306.724.72 euro dhe ai me i shtrenjeti ka qene OE-Astraplan me vleren 367.182.43.Deshmi e mjaftueshme se asnje OE nuk ka tejkaluar buxhetin. Vlene te ceket kerkesajone disa here me email per alokim te mjeteve mirepo AK-ja nuk na sidergon ate dokument duke mos u pergjigjur fare.

Prove: Proces verbali i evalvimit tenderit

Procesverbali i hapjes se tenderit.

Neni 7. Barazia ne trajtim / jo diskriminim paragrafi 1 dhe 2

Sqarim:AK-ja ka shkelur piken 1 te këtij ligji duke mos trajtuar ne mynyre te barabarte OE, konkretisht ne piken 9.2 duke mos marre per baze asnje dokument qe ne kemi dorzuar per deshmimin e pervojes se punes qe ne FDT thuhet citoj: - "letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar".Ndersa ne kemi ofruar per secilin inxhinier me shume se ne 2 dokumente deshmimin e pervojes se punes,duke deshmuar me Diploma, Kontrata,CV.listen e stafit profesional me exprience ne vite,referencat si dhe per projektimenaxherin eshte Licenca e zbatimit me date kur eshte drejtor teknik si dhe certifikata e regjistrimit te biznesit ku tregon se i njejti eshte edhe drejtor ligjore.

Provë :

- Kopjen e Diplomes me date te diplomimit per secilin inxhinier CV-ne per secilin inxhinier me pevoje te punes ku cdonjeri e ploteson kushtin e kerkuar nga AK-ja
- Referencat e vecanta me date per inxhineret duke plotesuar kerkesat e AK-se Lista e inxhiniereve me pervoje pune per te gjithe inxhinieret e kerkuar.
- Kontratat e punes per secilin inxhinier te kerkuar
- Dokumenti Licence Zbatimi ku tregon se projektmenaxheri Z.Robert Gegaj ka qene drejtor teknik ne te njejten kompani nga viti 2007.
- Certifikata e biznesit ku deshmon se Menaxheri i projektit Z.Robert Gegaj

eshte drejtor ligjore i kompanise dhe figuron ne regjistrim nga data 2004.

- Dokumenti nga ATK per pagesen e kontributeve per keta inxhiniere se paku per 3 vitet e fundit,dokument i dorzuar ne kerkesen per rishqyrtim.

Ak-ja gjithashtu nuk ka qene transparente duke mosderguar dhe duke moskonfirmuar dergimin e emailit te pretenduar me date 23.12.2017 dokument i cili asnjehere nuk ka arritur ne emailin tone.Ak-ja ka mundur qe te vertetoje edhe ne ATK deshmimin e dokumentacionit per inxhineret e paraqitur nga ne.

Provë : Databaza e shkembimit te emailave me AK-ne me permbajtje date dhe ore per secilin email te kembyer nga viti 2008 deri me daten e sodit (Askund nuk figuron emaili i pretenduar qe eshte derguar nga AK-ja).

Neni 8.Planifikimi i Prokurimit paragrafi I dhe 1.3

Ak-ja ka bere shkeljen e ketij neni duke anuluar aktivitetin e prokurimit per tejkalim Buxheti duke pasur parasyshe qe asnje OE nuk ka tejkaluar kete buxhet qe eshte caktuar me FDT 399,587.33 ndersa ofertajone ka qene 306.724.72 euro.

Provë: **Fdt e dosjes tenderit me piken 2.4 Vlera e parashikuar. Alokimi i mjeteve per vitin 2016 dhe 2017 per kete tender(dokument qe AK-ja nuk na e ka derguar asnjehere pas disa kerkesave tona me email). Procesverbali i hapjes tenderit.**

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës paragrafi 2,3,4,5

Ak-ja ka bere shkeljen e ketij neni duke mos u pergjigjur ne dy emailat tone per marrjen e dokumentacionit te Alokimit te mjeteve per kete tender per vitin 2016 dhe 2017.Ne kemi kerkuar disa here edhe permes emailit te na sigurohet ky dokument por AK-ja na dergon vetem dokumentin e evalvimit te tenderit dhe asnjehere dokumentin e dyte te kerkuar nga 11C. Ak-ja nuk ka promovuar transparence duke mos u siguruar dergimi i emailit te dates 23.12.2016(email qe ne nuk e kemi pranuar asnjehere),dhe duke na anuluar pa asnje komunikim tjeter ao kerkese per sqarim per pervojen e inxhinierve edhe pse te gjithe dokumentacionin deshmues e ka pasur ne dosje dhe ska pasur nevoje fare per sqarim te tille.

Prove:Kerkesa me email te dates 27.01.2017 ora 12.22 PM

Kerkesa e dyte me email te dates 27.01.2017 ora 4.15 PM

Pergjigjja me email e AK-se e dates 30.01.2017 dhe dergimi vetem i dokumentit per evalvim dhe asnjehere nuk dergohet dokumenti per alokim te mjeteve.

Databaza e emailit e dokumentuar qe nk kemi email me date 23.12.2016 nga AK-ja.

Neni 54. Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, paragrafi 1,1.1

Ak-ja ka bere shkeljen e ketij neni duke pretenduar se na kane derguar email me daten 23.12.2017 per Leter standarde per sqarim tenderi(email ky qe asnjehere nuk ka arritur tek ne)dhe gjoja se ka skaduar me 27.12.2016 dhe pas kesaj ne jemi eliminuar,ndersa AK-ja ne nuk na ka informuar per eliminim deri me date 26.01.2017 kur njekohesisht edhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Prove:Leter standarde per tenderuesin e eliminuar.(email i dates 26.01.2017)

Leter standarde per anulimin e aktivitetit te prokurimit...(email i dates 26.01.201.7)

Neni 55.Mënyrat e Komunikimit,paragrafi 1.

Ak-ja ka bere shkeljen e ketij ligji duke mos na informuar me shkrim ne asnje forme per emailin e dates 23.12.2016. Nese edhe kjo nuk mjafton ne do te jemi te detyruar qe ne databazen e portalit Qeveritar te kerkojm egzistencen e nje emaili te tille dhe me siguri qe do te vertetohet se ku eshte emaili i derguar.

Neni59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,paragrafi 2

Ak-ja ka shkelur kete nen duke mos kerkuar nga ne sqarimin per arsyet e eliminimit, edhe pse mendojme qe AK-ja ka pasur mjaft dokumentacion per te deshmuar pervojen e punes per inxhinieret tone. Ekzaminimi i tendereve nuk eshte bere konform Lipp-së, nuk mund te anashkalohen pa u verejtur nga ana e komisionit dokumentet qe ju pretendoni se na mungojn, ekzistenca e tyre eshte e veretetuar edhe nga ana e AK-se me rastin e qasjes ne dokumente zyrtare te dt.25.01.2016,ku Zyrtari i AK-se deklarohet se CV nuk pranohet si deshmi pa asnje sqarim apo dokument te shkruar pse CV nuk pranohet si deshmi.

Neni 62. Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit,paragrafi 1,1.2

Ak-ja ka shkelur kete ligj pasiqe ka perfunduar aktivitetin e prokurimit ne rastin kur asnje prej OE-ve nuk ka tejkaluar buxhetin qe vete e ka dhen AK-ja me dosjen e tenderit.

Provë : FTD

Procesverbali i hapjes se tenderit

Alokimi i mjeteve per kete aktivitet prokurimi

Sipas nenit 62 nuk keni asnje baze ligjore qe ju te anuloni kete AP, bazuar ne Njoftimin per kontrate dhe ne DT. Ku specifikishte e keni se parashikimi i kontrates eshte ne vlere : 399.587.37 e ku te gjithe OE ofertuesjane brenda buxhetit te parashikuar nga AK, dhe ketu nuk ka tejkalime buxhetore.

Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Ak-ja ka bere shkeljen e ketij neni duke mos na ftuar qe te qartesojme dokumentat dhe certifikatat e paraqitura nga ne.

Provë: Databaza e emailave qe ne nuk kemi pranuar nje informacion te tille. Edhe pse ne kemi dorezuar CV per inzhinjeret e kerkuar qe qartesojn pervojen e kerkuar nga AK, ne prapeseprape mund te bejm sqarimet e nevojshme.

Neni I 13. I Ligjit nr. 02/L-28-Menyra e berjes se njoftimeve

Citojme Ligjin:

Mënyrat e bërjes së njoftimeve

113.1. Njoftimet bëhen: a) me postë, me kusht që të ketë shërbim postar derë më derë në zonën, vendbanimin ose vendin e punës të palës që do të marrë njoftimin; b) personalisht, në rastet kur kjo mënyrë njoftimi nuk komprometon shpejtësinë e procedurës në zhvillim ose kur njoftimi me postë është i pamundur, c) me telegram, telefon, teleks, faks në rastet urgjente; d) me njoftim publik, i cili shpallet në vende publike, ose me njoftim të publikuar në dy gazetat më të shitura në zonën ose vendbanimin ose vendin e punës të palës që do të njoftohet, në rastet kur palët e interesuara nuk njihen ose janë në një numër kaq të madh saqë çdo mënyrë tjetër njoftimi konsiderohet e papërshtatshme.
113.2. Në raste të veçanta kur këtë e kërkon natyra e aktit, personi thirret të pranojë aktin personalisht.
113.3. Në rastet kur njoftimi bëhet me telegram, telefon, teleks ose faks, duhet të konfirmohet nga organi që bën njoftimin në njërën prej mënyrave të parashikuara në pikat a) dhe b) të paragrafit të parë të këtij neni, ditën që vjen pas ditës së punës, megjithëse si rregull njoftimi do të konsiderohet i kryer ditën e komunikimit të parë.

Sqarojem qe AK-ja ka shkelur kete ligj duke mos konfirmuar ne asnje forme marrjen e emailit ne adresen tone gje qe ne ate email nuk e kemi pranuar asnjehere.

Pra nuk qendron fakti se ne nuk kemi dorezuar deshmi per exprience sepse ne dosje kemi kontrata, CV, listen e stafit profesional me exprience ne vite, referencat si dhe per projektmenaxherin eshte Licenca e zbatimit me date kur eshte drejtor teknik si dhe certifikata e regjistrimit te biznesit ku tregon

se i njejti eshte edhe drejtor ligjore, dhe po qe se ne nje menyre ose tjetren per AK-ne duket e paqarte CV dhe keto dokumenta qe deshmojne pervojen ne jemi te gatshem kete ta deshmojn edhe ne forma te tjera konform Lpp-së . Edhe po qe se nuk do te kishim dorezuar fare CV-it AK ka qene dashte te veproj konform nenit 69 paragrafi 4.1 sepse ne kemi deshmuar se e plotesojm kete kriter bazuar ne dokumentet e ofruara ne Tenderin tone te dt. 27.11.2016. Ne te kunderten ne do te deshmojm se asnjehere nuk kemi pranuar nje email te tille siqe ju pretendoni (emaili i dt.23.12.2016) qe edhe ashtu ka qene i pa nevojshem sepse ne kemi plotesuar kerkesen tuaj si ne njoftimin per kontrate edhe ne DT. Propozojmë: Qe tenderi te KTHEHET NE RI VLERSIM duke pasur parasysh te gjitha shkeljet e lartcekura nga AK-ja.

Demet material:

Shpenzimet administrative dhe operative te përgatitjes se tenderit

Fitimi i humbur

Dëmtimi i imazhit te kompanisë sonë.

Veshtiresite për te mbijetuar te drejtën e përfituesit kur i plotëson te gjitha kriteret dhe nuk shperblehemi me kontrate publike, per te cilin buxhet te Republikes se Kosoves edhe ne si OE jemi kontributdhenes (taksapagues) , dhe kemi te drejte atehere kur i plotesojm kriteret te shperblehemi me dhenje te kontates e sidomos ne kete raste qe AK eshte MPB. Propozojrë: I.Qe Oshp te Anuloje vendimin e AK-se dhe tenderin ta KTHEJË NE RI VLERSIM duke pasur parasysh te gjitha shkeljet e lartcekura nga AK-ja.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , "Europa Partners", sh.p.k -Prishtinë

Pikat e Ankesës nga OE **"Europa Partners", sh.p.k-Prishtinë** *,dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Ne besojm se jemi demtuar nga Autoriteti Kontraktues në baze te Neni 55 Menyra e Komunikimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me datën 26.01.2017 në ora 9.48 përmes emailit zyrtar kemi pranuar nga AK - MPB shkresen:

- Letër standarde për tenderuesin e eliminuar,
- Njoftimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit me Titulli: "Ndertimi i aneks objektit te Agjencisë së Kosovës për Forenziké- Faza e II" dhe Nr. prokurimit : 214/16/052/521
- Njeherit dhe një foto e marrur nga Monitori i kompjuterit të AK, në të cilën tregohet se AK e ka dërguar këte email përmes të të cilit është dërguar kjo shkresë:
- Leter standarde per tenderuesin e suksesshem-para dhenies së kontratës
- EuropaPartners –ABC -pdf

Mirëpo në adresën ton elektronike këte email në nuk e kemi pranuar dhe as letren Standarde (per mes se ciles kerkon nga OE te dorezohen ne AK disa dokumente te nevojshme per plotesim per kohe te caktuar qe te mund te nenshkruhet kontrata). Gjatë analizës së fotos së dërguar kemi konstatuar së adresa në të cilën është dërguar ky email i datës 30.12.2016 në ora 11:45 nuk është e adresur në adresën e saktë , e cila është e shenuar në këte formë / "europapartners sh.p.k' / Kjo adresë nuk është

adresa jonë. Adresa jonë është, dhe e cila në çdo email të pranuar nga ky autoritet dhe nga autoritetete tjera është (duket) në këte formë: europapartners sh.p.k. <europapartners(a)hotmail.com.>: Andaj për këte arsye kërkojmë verifikim të adresës së emailit në të cilin është dërguar shkresa e datës 30.12.2016 si dhe Anulimin e Vendimit per Anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe të vazhdohet me aktivitetet e prokurimit sipas shkreses se dates 30.12.2016 Leter standarde per tenderuesin e suksesshem-para dhenies se kontrates-EuropaPartners-ABC-pdf (të cilën shkresë ne nuk e kemi pranuar).

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , OE "Astraplan" sh.p.k-Prishtinë

Pikat e Ankesës nga OE **"OE OE "Astraplan" sh.p.k- Prishtinë**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

- Nenit 8 i LPP-së nr.04/L-042- Planifikimi i Prokurimit
- Nenit 9 i LPP-së nr.04/L-042- Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
- Nenit 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Nenit 62 i LPP-së nr.04/L-042- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Nenit 69 i LPP-së nr.04/L-042-Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Nenin 39.8 te RRUOPP me tabelën e cekur ne nenin 39.8 kur mungon Lista origjinale duhet te eliminohet OE pa kërkuar sqarime, shih tabelën ne faqen 80 te RRUOPP.
- Neni 5 Ndarjet buxhetore të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës te PROJEKTLIGJ PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2017

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Autoriteti Kontraktues Ministrisë se Punëve te Brendshme ka bere shkelej te nenit 8 pasi kanë planifikuar mjetet për vitin fiskal dhe nuk është realizuar kontrata e punëve.

Autoriteti Kontraktues Ministrisë se Punëve te Brendshme ka bere shkelje te nenit 9 pasi para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formali nevojave për ketë Aktivitet te Prokurimit. Me këtë vlerësim te nevojave përcaktohen lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; gjate aktivitetit.

Autoriteti Kontraktues Ministrisë se Punëve te Brendshme ka bere shkelje te 9.2 dhe 9.3 pas vlerësimit te nevojave ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton për inicimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës te tenderit. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të filloj me publikim te tenderit.

AK i MPB ka bere shkelje te Nenit 5 Ndarjet buxhetore të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës te PROJEKTLIGJ PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2017 pasi mjetet janë te ndara siç shihet ne Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK)-regjistri kontabël i themeluar përbrenda Thesarit të Ministrisë së Financave SIMFK qe mjetet janë te ndara ne vlere prej 500.000.00 euro, prove tabela e Projektligj për Buxhetin e Republikës së Kosovës për

VITIN 2017, bashkangjitur ne këtë ankesë, ne formatin A3 vetëm e vetëm qe te shihet me mire. Po ashtu ky projekt është i parapare për dy vite kalendarike 2016 dhe 2017, me çka shihet se edhe nëse komplet projekti realizohet ne vitin 2017 mjaftojnë mjetet e vitit 2017 qe janë parapare sipas tabelës se buxhetit pa e llogaritu fare edhe buxhetin prej 203,402.00 € qe janë bartur siç e ka cek MPB ne vendimin për ri-shqyrtim me nr. protokoll 05/02. Shih tabelën e FTID-s ndarja e buxhetit për dy vite.

Vlera e parashikuar	2.4	399,5870.83€ (2 vjeqare) 120,000.00 € (për vitin 2016) 280,000.00€ (për vitin 2017)

Nga tabela e mësipërme shihet se për vitin e pare te punimeve janë parapare 120,000.00 €, ndërsa për vitin e dyte te punimeve 280,000.00 €, dmth ne te dy variantet mjafton buxheti.

AK i MPB ne vendimin e Rishqyrtimit e cek se janë edhe mjetet ne vlere prej 203,402.00 euro te bartura nga viti paraprak qe jep me kuptuar se mjete - buxhet ka për këtë projekt Kapital ne SIMFK janë ndare mjetet për këtë projekt qysh ne muajin nëntor 2016 kure edhe behët projekt-propozimi i buxheteve siç shite janë ndare mjete për investime kapitale ne vlere prej 500.000.00 euro.

Nëse autoriteti kontraktues është organizatë buxhetore prokurimi përkatës do të shkaktojë ngrirjen obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të sigurojë që mjetet për vitet e ardhshme sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore.

Ne baze te këtij neni 9 para 1-4 autoritet Kontraktues është pajtuar ZKA dhe ZKF qe fondet ekzistojnë dhe përgatisin dhe nënshkruaj deklaratën e nevojave për Disponushmerin e fondeve.

Ne baze te qasjeve ne dokumente zyrtare ne përputhje me nenin 10 te LPP-se kemi vërejtur se AK i MPB ka bere vlerësimin e pese (5) ofertave, ku 3 nga ofertat jan shpalle te papërgjegjshme nga komisioni i vlerësimit e po ashtu edhe nga menaxheri i prokurimit te MPB-se duke u bazuar ne raportin e vlerësimit. Pas analizës se raporti te vlerësimit dhe shikimit te ofertave vërejmë se AK me te drejte i ka anuluar OHE, si:

1. MERCOM COMPANY SHPK nuk i plotëson kërkesat e FTID-se dhe plotësisht është

i pa përgjegjshëm

2. EUROPA PARTNERS SHPK nuk i plotëson kërkesat e FTD-se dhe plotësisht është i pa përgjegjshëm.

3. OLITI TRASING SHPK i plotëson kërkesat e FTID-se mirëpo pas korrigjimeve aritmetikore del si OE me i shtrenjtë me çmim dhe ka ndryshime me shume se 2% dhe plotësisht është i pa përgjegjshëm. Ndërsa

4. TEKNO ING CONSULTING SHPK edhe pse nga komisioni është shpalle si I përgjegjshëm gjat qasjes ne dokumente vërejmë se nuk i plotëson kërkesat e FTD-se dhe plotësisht është i pa përgjegjshëm nga renditja e me sipërme vjen me radhe oferta e kompanisë Astraplan shpk e cila është përgjegjshëm dhe çmimi total i ofertës Tone është nen buxhetin e planifikuar-ndare për këtë kontrate, qe e plotësojmë kushtin: tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lire.Autoriteti Kontraktues Ministrisë se Punëve te Brendshme ka bere vlerësim te ofertave dhe ne përputhje me nenin 59 mirëpo te gjitha kompanitë me çmim me te lire se ne janë te pa përgjegjshme.

Kompanitë me te lira se ne nuk kane dorëzuar ofertat e tyre ne përputhje me LPP-ne dhe me Rregulloren dhe Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik pasi nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e vlerësimit.

Autoriteti Kontraktues Ministrisë se Punëve te Brendshme ka bere shkelje Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të plotësoj në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet e nenit 62 ku ne rastin konkret nuk qëndron asnjëra nga arsyet e anulimit te aktivitetit te prokurimit qe përshkruhen ne nenin 62 te LPP-s citojnë nenin 62; v(7.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokarimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit,

2. 4utoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, apo 2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose argjeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.)Nga sa shihet nga qasja ne dokumente ne jemi tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lire, dhe po ashtu jemi nen buxhetin e parapare te MPB-se, shih piken 2.4 te FTD:

Vlera e parashikuar	2.4	399.587,83€ (2 vjeqare) 12,000.00€ (per vitin 2016) 280,000.00 € (per vitin 2017)

Gjithashtu i Autoriteti Kontraktues Ministrisë se Punëve te Brendshme duhet te beje edhe vlerësimin ne përputhje me neni 69 dhe me RRUOPP me tabelën e cekur ne nenin 39.8 Lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat e FDT-s ne rastin konkret nuk është ne origjinal, duhet te eliminohet kompania pa kërkuar sqarime shtesë.

Problemi	**Si te veprohet**	**Neni i LPP-së**
Mungon referenca/ certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezentuara	Mund te kerkohet informata sqaruese	69
Lista e kontratave te realizuara e dorezuar nuk permbush kerkesat minimale te v leres se percktuar	Refuzohet tenderi pa kerkuar informata te metejshem	69

Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, nga Paneli Shqyrtues në OSHP kërkojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës Sonë te zbatoj Nenin 104 te LPP-se si dhe të bëjë sintezën dhe analizën e dyshimeve, kërkesave dhe pretendimeve të ngritura në këtë ankesë dhe se këtë aktivitet prokurimi ta kthej në RI-VLERESIM pasi qe e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lire.

Demet material:

Dëmtimi i imazhit te kompanisë, dëmtimi moral dhe humbja e kohës, shpenzimet material ne përgatitjen e ofertës,fitim i humbure sepse po te ishte vlerësimi real do te ishim fituesit e kësaj oferte, pasi qe i plotësojmë te gjitha kërkesat e tenderit dhe jemi oferta e përgjegjshme me çmimin me te lire.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	07.11.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	29.11.2016
Data e hapjes së ofertave	29.11.2016
Data e njoftimit tëanulimit në faqen e Krpp-së :	27.01.2017
Vlera e parapare per AP	399,587.83€

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Dëshmia e kërkuar dokumentare: a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).
b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës	b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).
Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit.	c. Vërtetimin nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).
	Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës te përgjegjshëm.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Dëshmia e kërkuar dokumentare: a. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit (kopje).
b. Regjistrimi për numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore.	b. Certifikatë me numër fiskal (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: NA	***Dëshmia e kërkuar dokumentare: NA***
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Personel prej minimumi 4 (katër) inxhinierëve të cilët drejtpërdrejt janë përgjegjës për ekzekutimin-realizimin e aktiviteteve të renovimit, të prezantohen: a.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** Personel prej minimumi 4 (katër) inxhinierëve: a. Menaxheri i projektit, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv ose inxhinier i diplomuar i arkitekturës - 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që

Menaxheri i projektit, duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv ose Inxhinier i diplomuar i arkitekturës - 3 vjet përvojë pune pas diplomimit; b. Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; c. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit;	dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. - vendimin për menaxher të projektit. B05 Njoftim per Kontrat elektroteknikës - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit; b. Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi hidroteknik - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. c. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë - 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, të dëshmohet me: - kopjen e diplomës universitare, - kontratë e punës (para nënshkrimit të kontratës me OE fitues). - letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar.
2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku dy kontrata të ndërtimeve ose renovimeve, të realizuara në tri vjetët e shkuara (2013, 2014, 2015).	2. Listën e kontratave të punëve që specifikojnë: punët e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmi certifikatën (certifikatat) e ekzekutimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje) ose raport të pranimit teknik (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i punëve për kontratat e cekura në listë.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Tekno ing consulting" shpk	Prishtinë	254,661.98 €	JO
2.	"Europa Partners" shpk	Prishtinë	325,786.00 €	JO
3.	"Olti Trasing" shpk	Prishtinë	338,503.50 €	JO
4.	"Mercom Company" shpk	Prishtinë	306,724.72 €	JO
5.	"Astraplan" shpk	Prishtinë	367,182.43 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 29.11.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë pesë (5) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Gëzim Qorraj
- - Anëtar i komisionit - Lavdërim Bullatovci
- - Anëtar i komisionit – Iliriana Rexhepi

Data e mbarimit të vlerësimit: 29.12.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....23.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Nga tenderet e përgjegjëshëm që kanë ofertuar për "Ndërtimi i aneks objektit të Agjensise së Kosoves për Forenzikë – Faza II", pasi që kriter për dhënjen e kontratës është tenderi i përgjegjëshëm me cmimin më të ulët, komisioni i vleresimit me rastin e vleresimit dhe krahasimit të tenderëve ka konstatuar se ofertuesi "Europa Partners & ABC", nga Prishtina, e ka ofruar cmimin më të ulët në shumën prej 325,786.00€.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarim hyrës: Pas ekzaminimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se Autoriteti Kontraktues – MPB, konkretisht komisioni vlerësues, sipas raportit të vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit, si ofertues të përgjegjëshëm ka kualifikuar operatorët ekonomik: "Europa Partners "shpk, "Tekno Ing Consulting" shpk dhe "Astraplan"shpk, ndërsa për dhënje të kontratës si të suksesëshëm e ka cilesuar OE "Europa Partners "shpk, duke e rekomanduar për dhënje të kontratës.

Sqarimi nr. 1 - Autoriteti Kontraktues - **"Ministria e Punëve të Brendshme"**, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontratë publike me vlerë të mesme. OE **"Mercom Company"shpk;** OE **"Europa Partners"**, dhe OE **"Astraplan" shpk,** kanë parashtruar ankesa veq e veq kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, respektivisht kundër arsyetimeve të shprehura në letra standarde kundrejt të njejtëve OE.

Arsyetimi i letres standarde kundrejt ofertës së parashtruesit të ankesës, "**Mercom Company**" shpk, porencon: *"... në faqen nr 4 të njoftimit për kontratë (kërkesa teknike dhe apo profersionale):...Ju në dosjen tuaj keni prezentuar ingjinjerin e diplomuar të artikturës, Robert Gegaj për të cilin keni bashkangjitur referenca për projektin por pa vitet e përvojës së mëparshme ingjinjerike në lëmin e caktuar. - Ju në dosjen tuaj të tenderit keni prezentuar ingjinierin e diplomuar të ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik, Zahir Osaj për të cilin keni bashkangjitur referencat për projektin por pa vite të përvojës së mëparshme ingjinjerike në lëmin e caktuar. - Ju në dosjen tuaj keni prezentuar ingjinjerin e diplomuar të elektroteknikës, Kristë Duzhmani për të cilin keni bashkangjitur referenca për projektin por pa vitet e përvojës*

së mëparshme ingjinjerike në lëmin e caktuar.- Ju në dosjen tuaj të tenderit keni prezentuar ingjinierin e diplomuar të makinerisë, Esat Kazazi për të cilin keni bashkangjitur referencat për projektin por pa vite të përvojes së mëparshme ingjinjerike në lëmin e caktuar, dmth nuk është prezentuar si është kërkuar i kompletuar përsoneli profesional për ingjinerët e kërkuar. ***Shenim****: me dt.23.12.2016, juve ju është dëruar në formë elektronike "Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit", për të dëshmuar përvojen e punës së inxhinierëve të prezantuar. Afati i fundit kohor për përgjigje ka qenë më 27.12.2016 në oren 15:00. Kompania juaj nuk është përgjigjur fare dmth nuk keni ofruar dëshmit e nevojshme brenda afatit kohorë të caktuar. Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë oferta juaj nuk kalon në velrsimin e mëtutjeshëm".*

Arsyetimi i letrës standarde kundrejt ofertës së parashtruesit të ankesës "**Europa Partners**", **shpk**, potencon: "*Nuk keni dorëzuar dëshmi siq është kërkuar në faqen 4, të njoftimit për kontratë (Kërkesat e përshtatshmërisë)...shënim: më datë 30.12.2016, juve ju është dërguar në formë elektronike "letër standarde për tenderuesin e suksesëshëm - para publikimit të njoftimit për kontratë", ku kemi kërkuar që para publikimit të njoftimit për dhënje të kontratës, ti dorezoni kërkon dokumete B. Vertetimin nga Administrata Tatimore (kopje), C. Vertetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Qështje Ekonimike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar - noterizuar nga Institucioni Kompetent i vendit të themelimit. Deri më dt.06.01.2017 në ora 15:00, kompania juaj nuk është përgjigjur fare, dmth nuk keni ofruar/dorzuar dëshmit e nevojshme brenda afatit kohor të caktuar*".

Arsyetimi i Letrës Standarde kundrejt ofertës së parashtruesit të ankesës OE "**Astraplan**" **sh.p.k**, potencon: "*Një dizpozit e ligjit të prokurimit kërkon anulimin e aktivitetit të Prokurimit. Informacion shtesë: të gjith tenderet e përgjigjëshëm përmbajn çmime që e tejkalojn buxhetin e AK-së*".

Kundrejt arsyetimeve të lartëpërmenduara, parashtruesit e ankesave sipas afatave të parapara ligjore kanë paraqitur kërkesa për rishqyrtim pranë AK-së, dhe atë si më poshtë:

- OE "Mercom Company" shpk, sipas përshkrimit në kërkesë më dt **30.01.2017,** me pretendimet ankimore se AK, ka bërë shkelje të nenit **6,7,8,54,55,59,62** dhe **72**, të LPP-së si dhe nenit **39,** të UOPP-së.
- OE "Europa Partners",shpk, sipas përshkrimit në kërkesë me dt **27.01.2017**, paraqet kërkesë për rishqyrim pranë AK-së , me pretendimet ankimore se AK, ka shkelur nenin **55** të LPP-së.
- OE "Astra Plan"shpk, sipas përshkrimit në kërkesë të dt **30.01.2017**, paraqet kërkesë pranë AK-së me pretendimet ankimore se është bërë shkelje e dispozitave të LPP-së dhe atë nenit **8,9,59,62**, dhe **69**, të ligjit për Prokurimin Publik në fuqi si dhe nenit **39**, të UOPP-së.

Kundrejt të njejtave kërkesa AK – MPB, më datën **31.01.2017**, nxjerr vendime veq e veq, dhe refuzonr kërkesat me arsyetimin se AK, ka bërë anulimin e këtijë aktiviteti të prokurimit konform nenit **62**, të LPP-së, për shkak të ndryshimeve substanciale në buxhet për këtë projekt.

Sqarimi nr. 2 - Fillimisht sqarojmë se parashtruesit e ankesave, si pikë të përbashkët ankimore, njëkohësisht pretendim kryesorë kanë arsytimin e anulimit të këtijë aktivitetit të prokurimit, ku AK – MPB, në njoftimin për anulim tekstualisht ka cituar: "*Të gjithë tenderet e përgjegjëshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit*".

Sqarojmë se sipas shkresave të lëndës së AK-së, bashkangjitur gjindet "Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve:", për këtë aktivitet të prokurimit në vlerën totale prej **399,587.83 €** (2 vjeqare), aprovuar nga ZKF, më datë **05.09.2016**, si dhe nga ZKA, më datën **31.08.2016,** poashtu në pikën **2.4**, të FDT-së, është e përshkruar e njejta vlerë.

Procesverbali i hapjes së ofertave i datës **29.11.2016**, përmban gjithësej pesë (5) ofertues, dhe se sipas përshkrimit të çmimeve rezulton që nuk është tejkaluar nga ndonjëri prej ofertuesve vlera e parashikuar, rrjedhimishtë vlerësimi ynë është që arsyetimi i anulimit të aktivitetit të prokurimit si i tillë në këtë fazë paraqet mos respektim të nenit **8** dhe **9** dhe **62**, të LPP-së, në fuqi. Për më tepër, paragrafi **2**, nënparagrafi **2.2**, i nenit **62**, të LPP-së shprehimisht thotë: "***Para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve***". Prandaj, në pajtim me sqarimin e mësipërme, vlerësojmë se pretendimi i palëve në ankesë (i përbashkët), për këtë pikë ankimore është i bazuar.

Sqarimi nr.3- Pretendim tjeter i OE "Mercom Company"shpk, ka të bëjë edhe me arsyetimin e eleminimit të shprehur në letër standarde, konkretisht me kërkesën, **9.1**, pika **1**, pozicioni **a,b,c** dhe **d**, të FDT-së. Poashtu të njejtin pretendim ankimroe e kualifikojmë si të bazuar, pasiqë për të njejtat kërkesa AK – MPB, si dëshmi dokumentare për përsonelin e kërkuar - ingjinjerët, ka kërkuar: - "*...letër referencë nga punëdhënësit ose çfardo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojen e mëparshme inxhinjerike në lëmin e caktuar".* OE, "Mercom Company"shpk, në shkresa të lëndës posedon listen e përsonelit me gjithesej **5**, inxhinjer, të pershkruar me përvojen të punës dhe atë si më poshtë:

- Kopjen e diplomës së z. Robert Gegaj, ingjinjer arkitekturës, sipas përshkrimit i diplomuar më datën 06.04.2005, kopjen e CV, si dhe "listen e referencave për punët që i njejti ka qenë pjesë e projekteve e lëshuar nga punëdhënësi me gjithesej **23** projekte të përshkruara.
- Kopjen e diplomes se z. Shemsedin Syle Abazi, sipas përshkrimit, i diplomuar më datë 26.12.1992, inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, kopjen e CV, si dhe listen e referencave për punët që i njejti ka qenë pjesë e projekteve, e lëshuar nga punëdhënësi me gjithësej **23** projekte të përshkruara.
- Kopen e diplomes së z. Kristë Gjergj Duzhmani, sipas përshkrimit, i diplomuar më datë 26.05.1998, inxhinjer i diplomuar i elektroteknikës, drejtimi elektroteknike industriale, kopjen e CV, si dhe listen e referencave për punët që i njejti ka qenë pjesë e projekteve e lëshuar nga punëdhënësi me gjithësej **16** projekte të përshkruara.
- Kopjen e diplomes së z. Zeqir Qazim Osaj, sipas përshkrimit, i diplomuar më datë 09.07.2007, inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik, kopjen e CV, si dhe listen e referencave për punët që i njejti ka qenë pjesë e projekteve, e lëshuar nga punëdhënësi me gjithësej **14** projekte të përshkruara.
- Kopja e diplomes se z. Esat Kazazi, sipas përshkrimit, i diplomuar më datë 27.03.2009, inxhinjer i diplomuar i Makinerise, kopjen e CV, si dhe listën e referencave për punët që i njejti ka qenë pjesë e projekteve e lëshuar nga punëdhënësi me gjithësej **20** projekte të përshkruara. Prandaj, në pajtim me sqarimin e mësipërme, vlerësojmë se stafi i prezantuar si i tille dhe me dëshmi dokumentare të tilla e mbulon kërkesën e AK-së, për përvojën e punës.

Sqarimi nr.4 - Pretendim tjeter ankimore i OE, "Mercom Company" shpk, është edhe për shkelje të nenit 54, të LPP-së. Sipas deklaratës në ankesë i njejti OE, potencon se AK, nuk e ka informuar për plotësim – sqarim të dokumentacionit deri më datën 26.01.2017, ditën kur AK, ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit. Poashtu edhe parashtruesi i ankeses "Europa Partners", përmes ankesës potencon se nuk ka pranuar lëter standarde, ku është kërkuar të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm para dhënjes së kontratës, duke pretenduar se AK, ka adresuar gabimisht kërkesën - shkresën.

Megjithatë në shkresa të lëndës së AK-së, ekziston kopja e shkresës, e printuar, dërgimi i e-mailit, më datë **23.12.2016**, adresuar sipas përshkrimit, To 'Mercom Company': Halil Elshani; Attachments: – Letër standarde për tenderuesin e eleminuar.

Poashtu parashtruesi i ankeses "Europa Partners", bashkangjitur me ankesë posedon kopjen e shkresës, e printuar, e-mailin, adresuar, sipas përshkrimit, To 'europapartners sh.p.k'; Subject: – Letër standarde e kërkesës për sqarim të tenderit.

Për të njejtën situatë eksperti shqyrtues sqaron se në konpjen e listës së operatorëve ekonomik të interesuar për këtë AP, (shkresë e bashkangjitur në lëndë të AK-së), figuron, emri i OE "Mercom Company"shpk, me email-adres të përshkruar "robert.gegaj@mercomcompany.com", (sipas shkresave të lëndës shifet se këmbimi i e-maileve është bërë përmes emailit "mercom2001@yahoo.com). Në po të njejtën listë figuron edhe emri i OE "Europa Partners"shpk, me email adresë të përshkruar: "europapartners@hotmail.com", poashtu pretendim ankimore i të njejtit OE.

Parashtruesit e ankesave OE "Mercom Copmpany"shpk, dhe OE "Europa Partners"shpk, përmes ankesave potencojnë se të njejtat shkresa elektronike (e-maile), nuk kanë arritur në adresat e tyre elektronike dhe si rezultat i mos pranimit të e-maileve, nuk kanë arritur të sqarojne dokumentacionin, respektivisht t'i përgjigjën kërkesës së AK-së.

Për të njejtat pretendime eksperti shqyrtues në mbështetje të asaj që u tha më lartë, sqaron se nuk mund të vërtetojmë nëse shkresat elektronike (e-mailet), kanë arritur në adresat e duhura, megjithatë vlerësimi ynë është që një gjë të tillë ndoshta mund ta bëjë Agjensioni i shoqërisë së informacionit, (ASHI), në kuader të Ministris së Administrates Publike – MAP.

Sqarimi nr. 5- Operatori ekonomik, "Astraplan", shpk, pretendim tjetër përveq arsyetimit të anulimit, që është trajtuar si i përbashket në sqarimin nr. 2, të këtijë raporti, përmes ankeses përveq ofertave të kualifikuara si të papërgjegjëshme nga AK- MPB, OE "Mercom Company"shpk, OE,"Europa Partners" shpk dhe OE "Olti Trasing", si dhe për OE, të kualifikuar si të përgjegjëshëm OE "Tekno Ing Consulting"shpk, potencon se gjatë qasjes ka verejtur se të njejtit nuk i plotesojnë kërkesat e FDT-së duke i cilësuar si të pa përgjegjëshëm.

Për të njejtin pretendim eksperti shqyrtues sqaron se parashtruesi i ankese OE "Astraplan" shpk, kundrejt operatoreve ekonomik të lartë përmendur sipas deklaratës në ankesë, nuk ka pershkruar ndonjë rrethanë faktike konkrete, qe perbën ose që ngrisin supozimin për shkelje të LPP-së, e që një gjë e tillë është e parapare në nenin 111, par 1.6, të LPP-së.

Mendimi i ekspertëve të OSHP-së :

- Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues që aktivitetin e prokurimit: ***"Ndërtimi i aneks Objektit të Agjencisë për Forenzikë-Faza II", me nr të prokurimit: 214/16/052/521***, të inicuar nga AK – MPB, ta kthej në **RI-VLERESIM.**
- Gjithashtu eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE **„Mercom Company"shpk; "Europa Partners"shpk,** dhe ankesa e OE **"Astraplan"shpk, të aprovohen si pjesërisht të bazuara.**